



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

MONITORUESI I LEGJISLATURËS SË VIII-TË

05/2025
PRILL, 2025

Autorë: Naim Jakaj dhe Melos Kolshi

Ekipi redaktues: Ehat Miftaraj, Betim Musliu dhe Gzim Shala

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Rockefeller Brothers Fund (RBF).

Implementuar nga:



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

Mbështetur nga:



RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD Rr. Ilaz Agushi
Prishtinë
E: info@kli-ks.org
www.kli-ks.org

Mars , 2025
Prishtinë, Republika e Kosovës

Për Monitoruesin e Legjislaturës

Monitorimi i Legjislaturës së VIII-të të Kuvendit të Kosovës bëhet në kuadër të Programit Qeverisja e Mirë të Institutit të Kosovës për Drejtësi. Ky monitorim bazohet në analiza të të dhënave për të përmirësuar funksionet kryesore kushtetuese të Kuvendit: funksionin përfaqësues, legjislativ, mbikëqyrës dhe zgjedhor.

Për më shumë informacione, vizitoni:
www.kli-ks.org

LISTA E SHKURTESAVE

KRK	Kuvendi i Republikës së Kosovës
ZKM	Zyra e Kryeministrit të Kosovës
POKP	Platforma Online e Konsultimeve Publike
RrPK	Rregullorja e Punës së Kuvendit
PL 2022	Programi Legjislativ për vitin 2022
GP LV	Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE!
GP PDK	Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës
GP LDK	Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës
GP AAK	Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës
GP LS	Grupi Parlamentar i Listës Serbe
GP MULTI ETNIK	Grupi Parlamentar i deputetëve nga komunitetet jo shumicë
IKD	Instituti i Kosovës për Drejtësi
GJK	Gjykata Kushtetuese
IAP	Institucioni i Avokatit të Popullit
KiE	Këshilli i Evropës
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
ME	Ministria e Ekonomisë
MBPZhR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Parathënie

Ky raport, edicioni i parë i Monitorimit të Kuvendit të Kosovës për Legjislaturën e VIII-të, është shumë më tepër sesa një analizë statistikore e funksionimit të institucionit më të lartë ligjvënës të vendit. Ai është pasqyrë e një periudhe të trazuar, ku Kuvendi jo vetëm që përfundoi mandatin e tij të rregullt kushtetues – për herë të parë në historinë e Kosovës – por gjithashtu u shndërrua në arenë të një lufte të hapur për pushtet, ku ekzekutivi dhe legjislativi shpesh nuk ishin aleatë të demokracisë, por kundërshtarë në një betejë për kontroll.

Zgjedhjet e vitit 2021 sollën një shumicë të paprecedent, një konfirmim i vullnetit të qytetarëve për ndryshim. Por me këtë shumicë absolute prej 58 vendesh, qeveria e Albin Kurtit u vendos në një pozitë të pashembullt: ajo nuk kishte nevojë për koalicion me partitë shqiptare. Në letër, kjo duhej të sillte një stabilitet të ri politik. Në realitet, ndodhi e kundërta. Kuvendi i Kosovës, institucioni ku duhej të zhvillohej debati i lirë dhe i hapur për të mirën e qytetarëve, u reduktua në makineri të votimit, ku shumica parlamentare kalonte ligje me shpejtësi, shpesh duke anashkaluar konsultimet publike, duke injoruar opozitën dhe, në dhjetëra raste, duke shkelur vetë Kushtetutën e vendit.

Gjetjet tona tregojnë prirje shqetësuese që nuk mund të neglizhohen: një qeveri që tentoi të zvogëlojë rolin e Kuvendit dhe një shumicë parlamentare që shpesh e përdori pushtetin e saj për të miratuar ligje dhe vendime në kundërshtim me frymën dhe shkronjën e aktit më të lartë të vendit. Për ne, këto veprime nuk janë thjesht devijime procedurale – por qëllim dhe rrezik i drejtpërdrejtë për prishjen e balancimit të pushteteve dhe për besimin e qytetarëve në institucionet shtetërore.

Mungesa e një kontrolli efektiv parlamentar mbi veprimet e qeverisë dhe trajtimi i Kuvendit si një instrument i ekzekutivit, e bënë legjislaturën e VIII-të, një periudhë të çrregullt dhe të mbushur me precedentë të rrezikshëm, të cilët, nëse nuk adresohen, mund të shërbejnë si model për degradimin e mëtejshëm të demokracisë parlamentare në Kosovë.

Pikërisht për këtë arsye, ne e pamë të domosdoshme një monitorim sistematik dhe rigoroz të Kuvendit, duke e shqyrtuar jo vetëm mënyrën e vendimmarrjes, por edhe përmbajtjen e vendimeve të marra. Qëllimi ishte i qartë: të garantojmë që institucionet e vendit funksionojnë mbi bazat e demokracisë dhe sundimit të ligjit, dhe jo mbi interesat e çastit të një mazhorance parlamentare të fuqishme.

Legjislatura e VIII-të duhet të mbetet një mësim që nuk duhet përsëritur – një paralajmërim për të ardhmen, dhe një rast për reflektim të thellë nga të gjithë aktorët politikë. Zvarritja e debateve, votimi i shpejtë i ligjeve, mungesa e një dialogu konstruktiv ndërmjet shumicës dhe opozitës, dhe përdorimi i Kuvendit si një "noter" i vendimeve të qeverisë, janë praktika që nuk guxojnë të përsëriten.

Kuvendi i Kosovës duhet ta ringjallë rolin e tij si shtylla kryesore e demokracisë – një hapësirë ku debatohen dhe hartohen ligje me transparencë dhe përgjegjësi, dhe jo një vend ku veprimet e qeverisë miratohen me shpejtësi pa analizë të mirëfilltë.

Në këtë drejtim, është e domosdoshme që legjislatura e IX-të të rrisë kontrollin parlamentar mbi ekzekutivin, të sigurojë që çdo ligj dhe vendim të shqyrtohet në detaje, dhe të krijojë një kulturë të re të llogaridhënies dhe transparencës.

Nëse Kosova dëshiron të ndërtojë institucione të forta, të qëndrueshme dhe me integritet, atëherë nuk ka më kohë për të përsëritur gabimet e së kaluarës. Kuvendi nuk mund të jetë një mjet i verbër në duart e ekzekutivit – ai duhet të jetë një institucion i pavarur, i fuqishëm dhe në shërbim të qytetarëve, e jo i pushtetit të ditës.

Ehat Miftaraj, Drejtor Ekzekutiv, Instituti i Kosovës për Drejtësi

Përmbledhje: Legjislatura e VIII-të, 2021-2025

Në shoqëritë demokratike me rend kushtetues parlamentar, është e domosdoshme që institucioni më i lartë përfaqësues i qytetarëve, siç është Kuvendi, t'i përmbushë detyrimet dhe përgjegjësitë që i janë garantuar me Kushtetutë, duke ushtruar funksionet kyçe për veprimtarinë e tij. Kuvendi luan rol qendror në formësimin e jetës publike, duke siguruar që opinionet qytetare të marrin vëmendjen e duhur, veprimet e ekzekutivit të analizohen dhe të mbikëqyren me kujdes, si dhe ligjet të miratohen në përputhje me interesin më të lartë të shoqërisë, në harmoni me Kushtetutën dhe parimet që ajo mishëron.

Kuvendi i Kosovës, gjatë legjislaturës së VIII-të, ka dështuar t'i përmbushë disa nga funksionet themelore për të siguruar një qeverisje efektive dhe në pajtim me Kushtetutën e Kosovës, kërkesat ligjore dhe Rregulloren e vet. Këtë legjislaturë e ka përcjellur mungesa e planifikimit strategjik dhe në disa raste, përmes vendimmarrjes ka shkelur Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi. Veç kësaj, puna e këtij institucioni është karakterizuar nga mungesa e transparencës së plotë, veçanërisht në lidhje me çështje të rëndësishme që kanë prekur drejtpërdrejt interesat e qytetarëve dhe integritetin institucional.

Një tjetër aspekt shqetësues ka qenë përkeqësimi i cilësisë së diskursit parlamentar. Në vijim të kësaj periudhe, Kuvendi është bërë skenë e përdorimit të një gjuhe joparlamentare, përfshirë gjuhën seksiste, raciste, mizogjene dhe homofobe, duke rrezikuar rëndësinë e një debati demokratik dhe gjithëpërfshirës. Kjo gjendje është përkeqësuar edhe më tej nga përplasjet fizike midis deputetëve në seanca plenare, një fenomen i papranueshëm për një institucion që duhet të jetë shembull i respektit dhe integritetit.

Raporti ka për qëllim jo vetëm vlerësimin e punës dhe aktiviteteve të zhvilluara gjatë kësaj periudhe, por gjithashtu tenton të shërbejë si udhëzues për legjislaturën e ardhshme. Ai thekson praktikat dhe fenomenet që nuk kanë kontribuar në një funksionim të duhur të Kuvendit dhe e drejton vëmendjen ndaj aspekteve që duhet të shmangen në legjislaturën e IX-të, për të siguruar një punë më të efektshme dhe të përgjegjshme.

Instituti i Kosovës për Drejtësi ka ndjekur punën e Kuvendit gjatë kësaj legjislature, ndërsa gjetjet e monitorimit të tij do të paraqiten sii në vijim:

1. Dështimi për ta miratuar Programin e Punës

Kuvendi ka punuar pa planifikim të duhur dhe pa miratuar programin e punës, ashtu siç kërkohet nga Rregullorja e Kuvendit të Kosovës.[1] Vetëm një herë gjatë vitit 2022, Kryesia e Kuvendit kishte autorizuar përgatitjen e planit të punës, por ky propozim nuk u shqyrtua as në Kryesi dhe as në seancë plenare. Përkundër miratimit të Rregullores së re dhe premtimit për zbatimin e kësaj rregulloreje, ku kërkohet miratimi i programit të punës për sesion, një gjë e tillë nuk ndodhi në vitin 2023 dhe 2024. Si rezultat, u krijua mungesë e vazhdueshme e efikasitetit në shqyrtimin dhe miratimin e pikave të rendit të ditës, një problem që vijoi të përsëritet nga seanca në seancë, dhe nga një vit në një tjetrin.

[1] Neni 19, par. 2; Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës; Korrik 2022.

Rekomandim: Kryesia e Kuvendit duhet të propozojë për miratim në seancë plenare programin e sesionit të punës së Kuvendit, në përputhje me dispozitat e Rregullores, për të garantuar planifikim dhe efikasitet më të mirë.

2. Funksionalizimi i vonshëm i votimit elektronik

Për tre vite të punës së Kuvendit, votimi elektronik nuk ishte funksional, rrjedhimisht Kuvendi dështoi t'u ofrojë qasje të plotë dhe transparencë në votim të deputetëve, qytetarëve të Kosovës dhe shoqërisë civile për mënyrën se si ka votuar një deputet i caktuar. Votimi elektronik u funksionalizua vetëm në sesionin e fundit të kësaj legjislature.[2]

Rekomandim: Kuvendi duhet të sigurojë publikimin e menjëhershëm të rezultateve për të garantuar transparencën dhe përgjegjësinë.

3. Përdorimi i seancës së jashtëzakonshme për miratim të pikave të rregullta

Në tre raste, Kuvendi keqpërdori mekanizmin e seancës së jashtëzakonshme për miratimin e pikave të rregullta të rendit të ditës.[3] Këto seanca u thirrën nga grupi parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! për t'i miratuar gjashtë pika të rregullta të rendit të ditës, të cilat nuk kishin arritur të miratoheshin në mungesë të kuorumit në tre seanca të rregullta plenare. Në mesin e këtyre pikave ishin edhe raportet e institucioneve të pavarura për punën e tyre në vitin 2021 (Raporti vjetor i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, Raporti vjetor i Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit dhe Raporti vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë). E njëjta situatë ishte edhe me rastin e thirrjes së seancës së jashtëzakonshme për miratimin e 11 pikave të rregullta të rendit të ditës, seancë kjo e mbajtur me 14 dhjetor 2023.[4]

Rekomandim: Kuvendi duhet të shmangë keqpërdorimin e seancave të jashtëzakonshme për çështje rutinore dhe të sigurojë kuorum të qëndrueshëm për trajtimin efektiv të pikave të rendit të ditës në seanca të zakonshme.

4. Interpretimi i gabuar për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme

Në një rast, IKD gjen se Kryetari i Kuvendit interpretoi gabimisht Rregulloren e Kuvendit për mosfillimin dhe mbajtjen e një seance të jashtëzakonshme për arsye se në sallë nuk ishin të pranishëm 61 deputetë.[5] IKD vlerëson se kuorumi në seancë plenare është i domosdoshëm dhe i patejkalueshëm për votimin e projektligjeve dhe akteve të tjera të Kuvendit, por kuorumi nuk duhet të jetë pengesë për zhvillimin e debatit parlamentar, veçanërisht kur ajo është e thirrur nga 1/3 e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, bashkësi deputetësh që me Kushtetutë kanë të drejtën e propozimit edhe të amendamenteve kushtetuese.

[2] Kuvendi mbajti seancën e parë për sesionin vjetor; Kuvendi i Kosovës; 12 shtator 2024; (Shih linkun <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/kuvendi-mbajti-seancen-e-pare-per-sesionin-vj-35725/>), (Qasur për herë të fundit me 10 janar 2024).

[3] Transkript i Seancës së Jashtëzakonshme; Kuvendi i Kosovës; 20 prill 2023; (Shih linkun https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2023_04_20_ts_Seanca_oral3.30_dwXpqXn3fS.pdf), (Qasur për herë të fundit me 10 janar 2024).

[4] Nga seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit; Kuvendi i Kosovës; 14 dhjetor 2023; (Shih linkun <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/nga-seanca-e-jashtezakonshme-e-kuvendit-34156/>), (Qasur për herë të fundit me 10 janar 2024).

[5] Nuk u mbajt seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit; Kuvendi i Kosovës; 4 shtator 2023; (Shih linkun <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/nuk-u-mbajti-seanca-e-jashtezakonshme-e-kuvend-33210/>), (Qasur për herë të fundit me 10 janar 2024).

Por, pas reagimit dhe interpretimit publik nga IKD në rrjetet sociale[6], seanca e jashtëzakonshme u mbajtë edhe pa qenë të pranishëm domdosdoshmërisht 61 deputetë në seancë.[7]

Rekomandim: Kryetari i Kuvendit duhet të sigurojë interpretim të saktë dhe të njëtrajtshëm të Rregullores së Kuvendit, duke mos e ndërlidhur praninë e 61 deputetëve me mbajtjen e seancave të jashtëzakonshme. Është e rëndësishme që të respektohet e drejta kushtetuese e 1/3 së deputetëve për të thirrur një seancë, duke mos e kushtëzuar zhvillimin e debatit parlamentar me kuorumin e votimit. Për të shmangur keqinterpretimet e së drejtës për debat, rekomandohet që Kuvendi të saktësojë dhe harmonizojë dispozitat për zhvillimin e seancave të jashtëzakonshme, duke i dhënë përparësi transparencës dhe funksionalitetit parlamentar.

5. Mungesa e shumicës parlamentare në seanca të jashtëzakonshme

Opozita në Kuvendin e Kosovës ka thirrur katër seanca të jashtëzakonshme për çështje me interes publik. Megjithatë, shumica parlamentare e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) ka bojkotuar këto seanca pa ofruar arsye të pranueshme, duke cenur rëndë vlerat demokratike dhe obligimet ndaj qytetarëve. Një bojkot i tillë është i dëmshëm, ngase pjesëmarrja aktive në debatet parlamentare është indikator për funksionimin e demokracisë dhe llogaridhënies. Mungesa e angazhimit të deputetëve është keqpërdorim i besimit publik, dëmton integritetin e Kuvendit dhe dëmton funksionimin kushtetues të kuvendit. Poashtu, deputeti ka për detyrë dhe obligim që të marrë pjesë në punimet e Kuvendit.

Rekomandim: Shumica parlamentare duhet të angazhohet në mënyrë aktive në debatet parlamentare, duke mos refuzuar obligimin për pjesëmarrje në seanca të jashtëzakonshme, duke respektuar detyrimet kushtetuese dhe interesin publik.

6. Kushtetutshmëria në ligjbërje

Në raport me kushtetutshmërinë në ligjbërje, Legjislatura e VIII-të është ajo që më së shumti ka prodhur kundërkushtetutshmëri. Kjo gjykatë, rrëzoi në tërësi Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Ligjin për Byronë Shtetërore për Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme dy ligjet më të rëndësishme të Reformës në Drejtësi. Më tutje, u rrëzuan pjesërisht Ligji për Pagat në Sektorin Publik dhe Ligji për Zyrtarët Publik, Ligji për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Në tërësi, u rrëzua Ligji për Masat e Përkohshme të Produkteve Themelore në Raste të Veçanta të Destabilizimit në Treg, Vendimi për shkarkimin e tetë (8) anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, Vendimi i Kuvendit për shkarkimin e anëtares së Bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit.[8]

Në disa raste GjK vlerësoi se është në përputhje me kushtetutën, Ligji për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, thirrja e seancës së dt. 13 korrik 2023 nga Kryetari i Kuvendit dhe Vendimi i Kuvendit për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave,

[6] Postim në rrjetin social Facebook; Naim Jakaj; 4 shtator 2023; (Shih linkun <https://www.facebook.com/share/p/16Cn2TGvNw/>), (Qasur për herë të fundit me 10 janar 2024).

[7] Kuvendi debatoi lidhur me tekstet shkollore; Kuvendi i Kosovës; 14 shtator 2023; (Shih linkun <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/kuvendi-debatoi-lidhur-me-tekstet-shkollore-33252/>), (Qasur për herë të fundit me 10 janar 2024).

[8] Shih për më shumë aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese në këtë link: <https://gjk-ks.org/decisions>

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, Vendimi i Kuvendit për shkarkimin e një anëtarit të KPK-së, Ligji për Investime të Qëndrueshme, Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Përcaktojnë Shumën e Beneficioneve në Lartësi të Pagës Minimale dhe Shkallët Tatimore në të Ardhurat Personale Vjetore.

Në procedurë të shqyrtimit në GJK janë edhe Ligji për Skemat Pensionale, Ligji për Zyrtarët Publikë, Ligji për Komisionin e Pavarur për Media, Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Vendimi i Kuvendit për statutin e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Ligji për Fondin Sovran.

16 ligjet e miratuara në seancën e 5 dhjetorit në procedurë të shqyrtimit në Gjykatë Kushtetuese

Për shkak të shkeljeve të procedurës së ndjekur për miratimin e 16 ligjeve dhe përmbajtjes së një ligji, PDK dorëzoi në Gjykatën Kushtetuese 16 ligje të miratuara në seancën e Kuvendit të Kosovës më 5 dhjetor 2024. Sipas PDK-së, përveç procedurës së ndjekur, edhe për nga përmbajtja është kontestuar Ligji për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme.

16 ligjet e kontestuar: Ligji për banim social dhe të përballueshëm, Ligji për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, Ligji për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, Ligji për Banka, Ligji për Inspektoratin Qendror për Mbikëqyrjen e Tregut, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, Ligji për shërbimet e pagesave, Ligji për provimin e maturës shtetërore, Ligji për Lojërat Mesdhetare "Prishtina 2030", Ligji për Gjykatën Administrative, Ligji për financimin e menaxhimit të resurseve ujore, Ligji për Inspektoratin Qendror të mjedisit, ujërave, natyrës, ndërtimit si dhe për mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore, Ligji për Inspektoratin Qendror të Trashëgimisë Kulturore, Ligji kundër dukurive negative në sport dhe Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurorinë Speciale.

Rekomandim: Për t'i shmangur kontestimet kushtetuese dhe për të përmirësuar cilësinë e ligjbërjes, Kuvendi i Kosovës duhet të respektojë rigorozisht procedurat parlamentare dhe standardet kushtetuese. Kjo përfshin konsultime më të gjera me ekspertë ligjorë dhe organizata të shoqërisë civile. Gjithashtu, duhet të forcohet roli mbikëqyrës i Komisionit për Legjislacion për të parandaluar shkeljet procedurale dhe për të siguruar që vendimet të bazohen në standarde të qarta juridike.

Përmirësimi i transparencës dhe konsultimi i detyrueshëm publik për projektligjet me ndikim të gjerë do të kontribuonte në hartimin e akteve më të zbatueshme dhe të harmonizuara me normat kushtetuese dhe standardet ndërkombëtare.

7. Gjuha joparlamentare

Kuvendi i Kosovës u përballë me klimë të tensionuar politike dhe përdorimin e gjuhës joparlamentare nga disa deputetë dhe anëtarë të kabinetit qeveritar. Kjo formë komunikimi jo vetëm që është kundër parimeve themelore të barazisë dhe respektit për të gjithë individët, por gjithashtu dëmtoi imazhin e Kuvendit si institucion demokratik dhe përfaqësues. Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2023 kritikoi atmosferën e polarizuar dhe përdorimin e gjuhës nxitëse dhe gjinore nga përfaqësuesit politik, duke theksuar ndikimin negativ të saj në promovimin e dialogut konstruktiv dhe ndërtimin e konsensusit për çështje të rëndësishme për vendin. Një sjellje e tillë rrezikon të forcojë stereotipat diskriminuese dhe të dobësojë besimin qytetar në lidhje me seriozitetin e institucioneve shtetërore.

Rekomandim: Deputetët e Kuvendit të Kosovës duhet të kenë kujdes të shtuar në Kuvend dhe jashtë tij, duke shmangur gjuhën ofenduese dhe joparlamentare, për të promovuar kulturën e debatit konstruktiv dhe të respektueshëm që përfaqëson dinjitetin e institucionit dhe qytetarëve që ata përfaqësojnë.

8. Dhunë fizike në seancë plenare

Kjo legjislaturë u karakterizua gjithashtu nga përplasjet fizike dhe rrëmujat mes anëtarëve të kabinetit qeveritar dhe deputetëve të opozitës, si dhe ndërmjet deputetëve opozitarë dhe shumicës parlamentare. Ndonëse për situatën e krijuar kërkohej pezullimi i seancës sipas Rregullores së Kuvendit, Kryetari i Kuvendit e vazhdoi mbledhjen. Për këtë rast, Prokuroria Themelore ngriti aktakuza kundër zëvendës kryeministrit dhe disa deputetëve për veprat penale si sulmi, lëndimi i lehtë trupor dhe dëmtimi i pasurisë, dhe më pas Gjykata Themelore në Prishtinë e konfirmoi këtë aktakuzë. Megjithatë, zv. Kryeministri dhe deputetët pranuan të ndjekin procedurën e ndërmjetësimit.

Rekomandim: Deputetët e Kuvendit, duhet të sigurojnë respektimin e standardeve profesionale dhe etike, duke zbatuar Rregulloren e Kuvendit. Është e domosdoshme që të krijohet kulturë më e fortë e respektit dhe bashkëpunimit ndërmjet deputetëve të pozitës dhe opozitës. Kuvendi duhet të jetë forum i debatit dhe jo vend për përplasje fizike apo verbale. Poashtu Kryetari i Kuvendit duhet të respektojë dispozitat e Rregullores në raste të tilla që kanë të bëjnë me pezullimin e seancave në raste konflikti dhe duke ndaluar çdo sjellje që cenon integritetin institucional dhe publik.

9. Shkeljet kushtetuese përmes moszbatimit të aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese

Më 23 dhjetor 2023, Gjykata Kushtetuese, shpalli disa dispozita të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik si antikushtetuese dhe kërkoi ndryshime nga Kuvendi me afat deri më 1 gusht 2024, por ky obligim ende nuk është përmbushur. Mosmiratimi i ndryshimeve në Ligjin për Pagat në Sektorin Publik nga Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës brenda afatit të përcaktuar sipas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, paraqet shkelje të këtij aktgjykimi, shpërfillje të kësaj Gjykate, shkelje të Kushtetutës, cenim të të drejtave në shtesë të pagës sipas përvojës së punës të dhjetëra-mijëra shërbyesve civilë në Kosovë, si dhe krijohet një praktikë e dëmshme për promovimin e demokracisë.

Rekomandim: Kuvendi i Kosovës, menjëherë pas konstituimit të Kuvendit dhe të formimit të komisioneve parlamentare duhet me urgjencë të ndërmarrin veprimet e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese për Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, duke garantuar respektimin e rendit kushtetues dhe promovimin e stabilitetit institucional.

10. Kushtëzimi i Kryeministrit dhe i ministrave për t'iu përgjigjur pyetjeve parlamentare

Në disa raste, Kryeministri i Kosovës dhe ministrat e kabinetit të tij, kushtëzuan përgjigjet në pyetjet parlamentare të deputetëve nga opozita me votimin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Kjo qasje është problematike, pasi të dyja këto çështje janë krejtësisht të ndara. Përgjigjja në pyetjet parlamentare është detyrim kushtetues i Kryeministrit dhe mekanizëm esencial i llogaridhënies dhe transparencës së Qeverisë ndaj Kuvendit dhe qytetarëve. Ky mekanizëm detyrues për kryeministrin, nuk duhet të trajtohet si zgjedhje apo mjet për të vendosur kushte politike, pasi cenon funksionimin demokratik të institucioneve dhe integritetin e sistemit parlamentar. Sipas Neni 97 të Kushtetutës së Kosovës dhe Neni 25 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Kosovës, për punën e saj, Qeveria përgjigjet Kuvendit të Kosovës, obligim për të cilin ajo se ka respektuar. Përgjegjësia e tillë ushtrohet përmes instrumenteve të mbikëqyrjes parlamentare të përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit.

Rekomandim: Kryeministri dhe ministrat duhet të respektojnë detyrimet kushtetuese dhe të përgjigjet në pyetjet parlamentare pa vendosur kushte, duke garantuar transparencë, llogaridhënie dhe respekt për parimet demokratike dhe rolin mbikëqyrës të Kuvendit.

11. Abuzimi me procedurën e përshpejtuar të miratimit të ligjeve

Legjislatura e VIII-të, është ajo që më së shumti ka përdorur procedurën e përshpejtuar për miratimin e ligjeve, duke shmangur afatet procedurale të rregullta dhe duke kufizuar hapësirën për konsultime publike. Kjo praktikë është evidentuar edhe nga Raporti i Progresit për vitin 2022[9] dhe 2024.[10] Afatet minimale të dhëna deputetëve për shqyrtimin e projektligjeve, janë në kundërshtim me standardet ndërkombëtare, të cilat lejojnë procedura të përshpejtuara vetëm për çështje teknike financiare dhe në situata emergjente. Qasja e tillë dëmton transparencën, përfshirjen publike dhe cilësinë e procesit ligjvënës.

Rekomandim: Kuvendi i Kosovës duhet të kufizojë përdorimin e procedurave të përshpejtuara vetëm për çështje urgjente dhe teknike, duke siguruar respektimin e afateve procedurale dhe hapësirë të mjaftueshme për konsultime publike, në përputhje me standardet ndërkombëtare për legjislacion cilësor dhe gjithëpërfshirës.

12. Mos respektimi i Rregullores së Kuvendit për ndarjet buxhetore për institucionet e pavarura

Ndryshimet që u bënë me rastin e miratimit të Rregullores së re përfshinin që ndarjet buxhetore

[9] Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2022; fq. 8"; 2022; Komisioni Evropian; (Shih linkun https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/1f855852-bfa9-4e7b-9f69-cd76127cade3_en?filename=Kosovo%20Report%202022.pdf), (Qasur për herë të fundit me 5 janar 2025)

[10] Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2024; fq. 22"; 2024; Komisioni Evropian; (Shih linkun https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43c1b6f01e10_en?filename=Kosovo%20Report%202024.pdf), (Qasur për herë të fundit me 5 janar 2025)

duke respektuar pavarësinë e këtij sistemi dhe duke u fokusuar në përmbushjen e detyrimeve të tyre për të mbështetur kërkesat ligjore dhe buxhetore të organeve të drejtësisë në mënyrë transparente dhe profesionale.

13. Arroganca e shumicës parlamentare në miratimin e ndarjeve buxhetore

Me rastin e miratimit të ndarjeve buxhetore vjetore me ligj, secili deputet i Kuvendit ka mundësinë që të parashtrojë amendamente të cilat sipas Rregullores së Kuvendit duhet të përmbajnë në mënyrë precize projektin e propozuar, koston financiare dhe prej nga ku do të merren ato para. IKD, ka gjetur se pjesa më e madhe e propozimeve që kanë qenë nga opozita parlamentare kanë plotësuar këto kritere.

Por, që shumica parlamentare në vazhdimësi është treguar arrogante sa i përket bashkëpunimit me deputetët opozitarë për miratimin e Ligjit për Ndarjet Buxhetore Vjetore për vitin 2022, 2023, 2024 dhe 2025. IKD gjen se me rastin e procedimit të këtij projektligji asnjë nga 54 amendamentet e propozuara në buxhetin vjetor të parashtruara nga deputetët e opozitës nuk janë votuar.

Rekomandim: Para se projektligji të miratohet në Qeveri (31 tetor) të konsultohet me partitë politike opozitare veçanërisht për projeksionet e mëdha të ndarjeve buxhetore. Pasi që buxheti të votohet suksesshëm në lexim të parë, shumica parlamentare në Komisionin për Buxhet dhe Financa së bashku me Ministrin e Financave, të dialogojnë dhe propozimet që mund të jenë të mira të merren parasysh dhe të miratohen edhe në seancë plenare.

14. Ndërhyrjet në sistemin e drejtësisë përmes deklaratave publike

Gjatë legjislatures së kaluar, janë evidentuar ndërhyrje të shpeshta në sistemin e drejtësisë përmes deklaratave publike të bëra në Kuvend.[11] Këto deklarata kanë sfiduar integritetin e organeve të drejtësisë dhe kanë ngritur dyshime për ndikime politike, duke cënuar parimin e ndarjes së pushteteve dhe duke kontribuar në uljen e besimit të qytetarëve në pavarësinë dhe funksionalitetin e sistemit të drejtësisë.

Rekomandim: Përfaqësuesit e pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv duhet të shmangin çdo deklaratë që mund të perceptohet si ndërhyrje në punën e sistemit të drejtësisë, duke respektuar pavarësinë e këtij sistemi dhe duke u fokusuar në përmbushjen e detyrimeve të tyre për të mbështetur kërkesat ligjore dhe buxhetore të organeve të drejtësisë në mënyrë transparente dhe profesionale.

15. Shpërfillja e iniciativave qytetare

Me iniciativën legjislative të mbi 10 mijë qytetarëve, Kuvendit të Kosovës i është paraqitur një projektligj për faljen e masave ndëshkimore gjatë COVID-19, por përfaqësuesit të kësaj nisme nuk i'u dha mundësia ta prezantojë atë para deputetëve, duke u kërkuar atyre që të caktojnë një deputet për ta bërë këtë.

[11] Naim Jakaj dhe Eranda Zekaj; Ndërhyrjet në sistemin e drejtësisë përmes deklaratave publike; 2023; (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2023/12/Nderhyrjet-ne-sistemin-e-drejtësisë-permes-deklaratave-publike-1-1.pdf>), (Qasur për herë të fundit me 5 janar 2025)

Kjo kërkesë u kundërshtua nga përfaqësuesi, por çështja mbeti pa zgjidhje, duke lënë projektligjin në pritje. Qasja e tillë injoruesepër përfaqësuesit dhe qytetarët që mbështetën nismën, dëmton parimet e demokracisë dhe pjesëmarrjen qytetare në procesin vendimmarrës, gjë që mund të dekurajojë angazhimin e tyre në të ardhmen.

Rekomandim: Kryesia e Kuvendit, në seancën e parë plenare të Legjislaturës së IX-të, të ftojë përfaqësuesin e nismës qytetare që të prezantojë nismën qytetare në seancë plenare, sipas kërkesës së tij dhe në pajtim me Ligjin për Nisma Legjislative.

16. Përdorimi i gjuhës joparlamentare

Kuvendi i Kosovës u përballë me klimë të tensionuar politike nga përdorimi i gjuhës joparlamentare nga disa deputetë dhe anëtarë të kabinetit qeveritar. Kjo formë komunikimi jo vetëm që është kundër parimeve themelore të barazisë dhe respektit për të gjithë individët, por gjithashtu dëmtoi imazhin e Kuvendit si institucion demokratik dhe përfaqësues. Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2023[12] kritikoi atmosferën e polarizuar dhe përdorimin e gjuhës nxitëse dhe gjinore nga përfaqësuesit politik, duke theksuar ndikimin negativ të saj në promovimin e dialogut konstruktiv dhe ndërtimin e konsensusit për çështje të rëndësishme për vendin. Një sjellje e tillë rrezikon të forcojë stereotipat diskriminuese dhe të dobësojë besimin qytetar në lidhje me seriozitetin e institucioneve shtetërore.

Rekomandim: Deputetët e Kuvendit të Kosovës duhet të kenë kujdes të shtuar në Kuvend dhe jashtë tij, duke shmangur gjuhën ofenduese dhe joparlamentare, për të promovuar një kulturë debati konstruktiv dhe të respektueshëm që përfaqëson dinjitetin e institucionit dhe qytetarëve që ata përfaqësojnë.

17. Largimi i paligjshëm i deputetëve serbë nga salla

Gjatë seancës së 5 dhjetorit 2024, Kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, kërkoi largimin e deputetëve të Listës Serbe, duke e konsideruar praninë dhe sjelljet e tyre provokuese si të papranueshme dhe të patolerueshme. Ai akuzoi deputetët e kësaj liste për keqpërdorim të fondeve publike dhe mbështetje të grupeve kriminale, duke ndërprerë seancën dhe kërkuar lirim të sallis. Sipas Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, ardhja e tyre një herë në gjashtë muaj është keqpërdorim i parave të taksapaguesve.[13]

Ky veprim i Kryetarit përbën pengim të jashtëligjshëm të pjesëmarrjes së deputetëve në punimet e Kuvendit, duke shkelur mandatin e tyre kushtetues, i cili garanton të drejtën për të marrë pjesë në seanca plenare në mënyrë të papenguar.

Kjo situatë gjithashtu përbën edhe shkelje të Rregullores së Punës së Kuvendit, pasi largimi i deputetëve nga seancat duhet të bëhet vetëm në përputhje me kushtet dhe arsyet e përcaktuara qartë në rregullore. Çdo veprim që devijon nga këto standarde cenon integritetin procedural dhe funksionimin demokratik të Kuvendit.

[12] Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2023; fq. 8 dhe 9; 2022; Komisioni Evropian; (Shih linkun https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/760aacca-4e88-4667-8792-3ed08cdd65c3_en?filename=SWD_2023_692%20Kosovo%20report_0.pdf), (Qasur për herë të fundit me 5 janar 2025)

[13] Deputetët e Listës Serbe pengohen që të nënshkruhen në Kuvend, Serbia reagon; 5 dhjetor 2024; Evropa e Lirë; (Shih linkun <https://www.evropaelire.org/a/lista-serbe-kuvendi-i-kosoves-nenshkrim-mandate-/33228114.html>), (Qasur për herë të fundit me 5 janar 2025)

Rekomandim: Kryetari i Kuvendit duhet të përmbahet nga veprimet politike dhe të veprojë në përputhje me Rregulloren e Punës, duke garantuar të drejtën e secilit deputet për pjesëmarrje dhe duke shmangur çdo pengim të pajustificuar.

18. Deputetët me aktakuza

Gjatë vitit 2022 IKD ka identifikuar 12 deputetë (në mesin e tyre edhe ish-deputetë, tani ministra) që janë përballur me ligjin. Në këtë numër prijnë deputetët e LVV-së, pastaj AAK-së dhe të PDK-së. Poashtu IKD, ka identifikuar njëmbëdhjetë deputetë që gjatë vitit 2023 janë përballur me ligjin. Në këtë numër kanë prirë deputetët e LV-së, pastaj AAK-së, më tutje PDK-së dhe grupit parlamentar MULTIETNIK. Po ashtu, deri në fund të legjislaturës së VIII-të, Kuvendi vazhdoi të përbëhet nga deputetë të cilët kanë probleme me ligjin. Sipas të dhënave nga monitorimi i IKD, nga 120 deputetë, tetë prej tyre kanë raste aktive në gjykata derisa një deputete ka dënim të formës së prerë. Shprehur në përqindje, 7.5% e deputetëve të Kuvendit janë persona të cilët kanë probleme me Ligjin. Pjesa më e madhe e deputetëve që kanë raste aktive, apo pesë prej tyre, i takojnë Grupit Parlamentar të LVV-së, dy i takojnë atij të AAK-së, si dhe njëra deputete që këtë vit ka kaluar nga LVV në LDK. Në këto 11 raste aktive, përfshihen 11 vepra penale me të cilat përballen këta tetë deputetë. Prej tyre, vepra penale më e shpeshtë del të jetë “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”, konkretisht tetë herë. Më pas, në dy raste kemi të bëjmë edhe me vepra penale të natyrës korruptive, specifikisht keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar. Ndërkaq, vepra penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” është e paraqitur në një rast.

Rekomandim: Partitë politike duhet të sigurojnë që në listat e tyre zgjedhore të përfshihen vetëm kandidatë që plotësojnë standardet më të larta të integritetit dhe nuk kanë probleme me ligjin, në mënyrë që Kuvendi të përfaqësojë një pasqyrë të besueshme dhe të pastër për qytetarët.

19. Dështimi për t'i publikuar materialet e komisioneve hetimore

Në secilin rast të themelimit të komisioneve hetimore, ka dështuar t'i publikojë materialet e komisioneve hetimore parlamentare, veprimi i cili cenon transparencën dhe llogaridhënien, duke ndikuar negativisht në besimin e publikut dhe vlerat demokratike.

Në Legjislaturën VIII, KHP-të nuk kanë respektuar parimet e transparencës përmes mospublikimit të procesverbaleve dhe transkripteve të mbledhjeve publike. Ligji për Hetim Parlamentar nuk ndalon publikimin e këtyre dokumenteve për mbledhjet publike, por nuk është zbatuar në mënyrë të plotë. Kjo mungesë transparence nuk përkon me interesin publik dhe pengon funksionimin demokratik të komisioneve. Përmirësimi i qasjes së publikut në informacion mbi punën e komisioneve është qenësor për të siguruar funksionimin efektiv të qeverisjes demokratike.

Rekomandim: Kuvendi i Kosovës duhet të publikojë procesverbalet dhe transkriptet e mbledhjeve publike të komisioneve hetimore parlamentare për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie. Po ashtu, Kuvendi duhet të nisë së zbatuari një platformë që vendoset brenda faqes së Kuvendit ku janë të pasqyruara të gjitha komisionet e themeluara nga Legjislatura e I-rë, ku vendosen propozimi për themelimin e KHP-ve, procesverbalet dhe transkriptet dhe raportet përfundimtare.

18. Deputetët me aktakuza

Gjatë vitit 2022 IKD ka identifikuar 12 deputetë (në mesin e tyre edhe ish-deputetë, tani ministra) që janë përballur me ligjin. Në këtë numër prijnë deputetët e LVV-së, pastaj AAK-së dhe të PDK-së. Poashtu IKD, ka identifikuar njëmbëdhjetë deputetë që gjatë vitit 2023 janë përballur me ligjin. Në këtë numër kanë prirë deputetët e LV-së, pastaj AAK-së, më tutje PDK-së dhe grupit parlamentar MULTIETNIK. Po ashtu, deri në fund të legjislaturës së VIII-të, Kuvendi vazhdoi të përbëhet nga deputetë të cilët kanë probleme me ligjin. Sipas të dhënave nga monitorimi i IKD, nga 120 deputetë, tetë prej tyre kanë raste aktive në gjykata derisa një deputete ka dënim të formës së prerë. Shprehur në përqindje, 7.5% e deputetëve të Kuvendit janë persona të cilët kanë probleme me Ligjin. Pjesa më e madhe e deputetëve që kanë raste aktive, apo pesë prej tyre, i takojnë Grupit Parlamentar të LVV-së, dy i takojnë atij të AAK-së, si dhe njëra deputete që këtë vit ka kaluar nga LVV në LDK. Në këto 11 raste aktive, përfshihen 11 vepra penale me të cilat përballen këta tetë deputetë. Prej tyre, vepra penale më e shpeshtë del të jetë “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”, konkretisht tetë herë. Më pas, në dy raste kemi të bëjmë edhe me vepra penale të natyrës korruptive, specifikuat keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar. Ndërkaq, vepra penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” është e paraqitur në një rast.

Rekomandim: Partitë politike duhet të sigurojnë që në listat e tyre zgjedhore të përfshihen vetëm kandidatë që plotësojnë standardet më të larta të integritetit dhe nuk kanë probleme me ligjin, në mënyrë që Kuvendi të përfaqësojë një pasqyrë të besueshme dhe të pastër për qytetarët.

19. Dështimi për t'i publikuar materialet e komisioneve hetimore

Në secilin rast të themelimit të komisioneve hetimore, ka dështuar t'i publikojë materialet e komisioneve hetimore parlamentare, veprimi i cili cenon transparencën dhe llogaridhënien, duke ndikuar negativisht në besimin e publikut dhe vlerat demokratike.

Në Legjislaturën VIII, KHP-të nuk kanë respektuar parimet e transparencës përmes mospublikimit të procesverbaleve dhe transkripteve të mbledhjeve publike. Ligji për Hetim Parlamentar nuk ndalon publikimin e këtyre dokumenteve për mbledhjet publike, por nuk është zbatuar në mënyrë të plotë. Kjo mungesë transparence nuk përkon me interesin publik dhe pengon funksionimin demokratik të komisioneve. Përmirësimi i qasjes së publikut në informacion mbi punën e komisioneve është qenësor për të siguruar funksionimin efektiv të qeverisjes demokratike.

Rekomandim: Kuvendi i Kosovës duhet të publikojë procesverbalet dhe transkriptet e mbledhjeve publike të komisioneve hetimore parlamentare për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie. Po ashtu, Kuvendi duhet të nisë së zbatuari një platformë që vendoset brenda faqes së Kuvendit ku janë të pasqyruara të gjitha komisionet e themeluara nga Legjislatura e I-rë, ku vendosen propozimi për themelimin e KHP-ve, procesverbalet dhe transkriptet dhe raportet përfundimtare. Një propozim i detajuar gjindet në raportin e IKD-së “Mos efikasiteti i hetimit parlamentar – Mungesë e vullnetit dhe problemet ligjore”.^[14]

[14] Mos efikasiteti i hetimit parlamentar (Mungesë e vullnetit dhe problemet ligjore), 2024; Instituti i Kosovës për Drejtësi; (Shih linkun: <https://kli-ks.org/dobët-raport-i-monitorimit-te-punes-se-kuvendit-te-kosoves-per-vitin-2022/>), (Qasur për herë të fundit më 5 janar 2025).

20. Mungesa e deputetëve të komunitetit serb në Kuvend

Dorëheqjet e deputetëve dhe shumë zyrtarëve të tjerë serbë nga institucionet e Kosovës filluan në fillim të nëntorit të vitit 2022, si pasojë e pakënaqësisë me vendimin e Qeverisë së Kosovës për të zbatuar planin me tri faza për reregjistrimin e automjeteve që mbajnë targa të paligjshme serbe. Deputetët që u dorëhoqën, u zvëndësuan me nëntë deputetët e rinj të kësaj partie të cilat u betuan në Kuvendin e Kosovës për të "verifikuar teknikisht mandatet e tyre" dhe "për t'i mbajtur ato në duar të sigurta", thuhej në një komunikatë të Listës Serbe.[15]

Përveç mungesës së vazhdueshme të tyre, deputetët e Listës Serbe nuk morën pjesë në asnjë prej votimeve të rëndësishme në Kuvendin e Kosovës. Kjo mungesë e tyre ka pamundësuar miratimin e ligjeve me interes vital dhe të amendamentit kushtetues nr. 27, i cili do të inkorporonte Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në nenin 22 të Kushtetutës dhe miratimit të amendamenteve kushtetuese në lidhje me vetingun.

Rekomandim: Rekomandohet që Lista Serbe të rifillojë pjesëmarrjen aktive në punimet e Kuvendit, duke përmblusur përgjegjësitë kushtetuese dhe duke propozuar përfaqësuesit në organet dhe komisionet përkatëse. Pjesëmarrja e tyre është e domosdoshme për të siguruar përfaqësimin efektiv të qytetarëve serbë si pjesë e komunitetit joshumicë dhe për të kontribuar në miratimin e reformave dhe ligjeve me interes vital për të gjithë qytetarët e Kosovës.

21. Mungesa e një nënkryetari në Kryesinë e Kuvendit dhe Kryetarit të një Komisioni në mungesë të propozimit të Lisës Serbe

Edhe pse me Kushtetutën e Kosovës, Listës Serbe i takon të propozojë njërin nga nënkryetarët e Kryesisë, ata ende nuk e kanë bërë një gjë të tillë. LS ende nuk ka propozuar edhe kryetarin e Komisionit për të Drejtat e Komuniteteve dhe për Kthim si njëri ndër komisionet parlamentare kushtetuese dhe komision i përhershëm, e për më tepër nuk ka propozuar as anëtarët e këtij komisioni. Lista Serbe nuk ka propozuar edhe anëtarët e tjerë për komisionet e tjera të përhershme dhe funksionale.

Mungesa e propozimit të këtyre pozitave është shkelje kushtetuese dhe ligjore dhe në kundërshtim me parimin e përfaqësimit, besim për të cilin qytetarët serbë u kanë dhënë për ta kryer në mënyrën më të mirë.

Rekomandim: Në Legjislaturën e ardhshme, Lista Serbe duhet të kryejë obligimet kushtetuese dhe ligjore, duke propozuar përfaqësuesit e saj për pozitat drejtuese në Kuvend, përfshirë Nënkryetarin e Kuvendit dhe Kryetarin e Komisionit për të Drejtat e Komuniteteve dhe për Kthim. Për më tepër, ajo duhet të sigurojë emërimin e anëtarëve të komisioneve të përhershme dhe funksionale, duke përmblusur kështu detyrimin e saj për të garantuar përfaqësimin e drejtë dhe të plotë të qytetarëve serbë në institucionet e Kosovës.

[15] Lista Serbe: I morëm mandatet në Kuvend për t'i ruajtur; 17 nëntor 2022; Evropa e Lirë; (Shih linkun <https://ëëë.evropaelire.org/a/deputetet-serb-betohen-ne-kuvend/32134901.html>), (Qasur për herë të fundit me 5 janar 2025).

22. Mungesa e deklarimeve nga Lista Serbe

Mungesa e deklarimeve nga Lista Serbe në Kuvendin e Kosovës për çështje jashtë rendit të ditës përbën dështim në përfaqësimin e interesave të komunitetit serb. Pavarësisht kompetencave dhe të drejtave të veçanta të garantuara nga Kushtetuta dhe legjislacioni, Lista Serbe nuk ka shfrytëzuar këtë pikë të rendit të ditës për të ngritur çështje të rëndësishme ekonomike, sociale dhe shëndetësore që prekin komunitetin që ata përfaqësojnë. Ky pasivitet e ka zbehur rolin e përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë në procesin legjislativ, duke lënë zërin e qytetarëve serbë të Kosovës të papërfaqësuar.

Rekomandim: Lista Serbe duhet të angazhohet aktivisht në Kuvend duke shfrytëzuar mundësitë për deklarata jashtë rendit të ditës, për t'i adresuar çështjet e përditshme të komunitetit serb dhe për të siguruar përfaqësim efektiv.

23. Mosefikasiteti që u bart

Kuvendi e nisi vitin 2022 me tre seanca plenare të papërfunduara nga vitit 2021, me gjithsej 38 pika të rendit të ditës.

Kuvendi e nisi vitin 2023 me tetë seanca plenare të papërfunduara nga vitit 2022, me gjithsej 54 pika të rendit të ditës të cilat nuk u përfunduan gjatë vitit 2022.

Kuvendi e nisi vitin 2024 me 27 pika të papërfunduara nga viti 2023, ndërsa legjislatura e VIII-të përfundoi duke mos i përfunduar gjashtë seanca plenare me 11 pika të rendit të ditës, dhe me 21 pika të tjera në rend të ditës, pika që i kanë plotësuar kushtet formale për t'u shqyrtuar dhe miratuar në seancë plenare.

Ky mosefikasitet i Kuvendit është reflektuar në mënyrë të përsëritur përmes mosrealizimit të pikave të rendit të ditës dhe grumbullimit të detyrave të papërfunduara nga periudha në periudhë. Ky model tregon mungesë planifikimi dhe menaxhimi efektiv, duke penguar përmbushjen në kohë të agjendës legjislative dhe mbikëqyrëse, si dhe duke cenuar efikasitetin e përgjithshëm të institucionit.

Përderisa kemi pasur moskryerje të pikave të rendit të ditës në secilin sesion, Legjislatura e VIII-të përfundoi edhe me 45 projektligje të pamiratuara, prej të cilave 17 kanë kaluar në lexim të parë.

Rekomandim: Kuvendi duhet të sigurojë përmbushjen e të gjitha detyrimeve brenda sesioneve dhe vitit kalendarik, duke mos lejuar që çështjet e papërfunduara të mbeten të bartura në vitin vijues.

24. Vonesat në zgjedhjen e organeve kolegjiale dhe individuale

Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kuvendi është organi prej të cilit zgjidhen një pjesë e konsiderueshme e pozitave në institucionet e pavarura kushtetuese. Ky rol realizohet në përputhje me kompetencat kushtetuese dhe ligjore, duke supozuar përzgjedhjen e zyrtarëve të kualifikuar dhe të përshtatshëm, nga të cilët pritet të garantojnë funksionimin e këtyre institucioneve.

Për të përmbushur këtë detyrë, Kuvendi duhet të sigurojë që proceset e emërimit të jenë transparente dhe të përgjegjshme.

Gjetjet e Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), gjatë kësaj legjislature tregojnë që Kuvendi dështoi të përzgjedhë dhjetëra zyrtarë për pozita kyçe, duke lënë të paplotësuara emërimet në 18 institucione të rëndësishme për periudha të gjata kohore. Në mësin e institucioneve që Kuvendi dështonte t'i përzgjedhte janë dy gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese, tre anëtarë në Komisionin e Pavarur të Mediave, dy anëtarë në Komisionin e Pavarur të Konkurrencës, dy anëtarë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, dy anëtarë në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, Guvernatorin e Bankës Qendrore të Kosovës, Bordin e Fondit të Kursimeve Pensionale, Komisionin për Ndhimë Shtetërore, dhe të tjera.[16]

Në vitin 202, Kuvendi arriti të plotësojë shumicën e këtyre pozitave të paplotësuara nga viti paraprak. Megjithatë, në vitin 2024 disa pozita mbetën ende vakante, duke përfshirë dy gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese, dy anëtarë të Komisionit të Pavarur të Mediave nga radhët e gjinisë femërore, një anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radhët e komunitetit serb dhe tre anëtarë të tjerë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti shqiptar.[17]

Rekomandim: Kuvendi duhet të sigurojë plotësimin e të gjitha pozitave kyçe përmes proceseve transparente dhe brenda afateve ligjore për të garantuar funksionimin e institucioneve kolegjiale dhe individuale.

25. Mungesa e bashkëpunimit të qeverisë me opozitën për miratimin e buxhetit

Për katër vjet në pushtet, mazhoranca ka treguar mungesë të theksuar bashkëpunimi gjatë procesit të miratimit të buxhetit, duke refuzuar sistematikisht çdo propozim të opozitës dhe duke ndjekur në mënyrë të njëanshme vetëm idetë e saj. Kjo qasje e mbyllur dhe jo bashkëpunuese ka krijuar një klimë politike të re dhe ka dëmtuar dialogun institucional, duke rrezikuar mirëqenien e qytetarëve dhe përfaqësimin e drejtë të interesave të ndryshme shoqërore.

Rekomandim: Shumica të adoptojë një qasje më të hapur dhe bashkëpunuese gjatë procesit të miratimit të buxhetit, duke përfshirë konstruktivisht propozimet e opozitës dhe grupeve të interesit, për të forcuar dialogun institucional dhe përfaqësimin gjithëpërfshirës të interesave qytetare.

26. Dështimi për ta miratuar Kodin e Sjelljes

Kuvendi i Kosovës ka dështuar të miratojë Kodin e Sjelljes për deputetët, pavarësisht se Rregullorja e re e Punës, e parasheh atë në nenin 129. Mos miratimi i këtij kodi brenda afatit të paraparë me Rregulloren e Kuvendit tregon edhe dështimin e Kuvendit për t'i kryer punët e veta.

[16] Naim Jakaj, DOBET – Raport i monitorimit të punës së Kuvendit të Kosovës për vitin 2022; 2023; (Shih linkun: <https://kli-ks.org/dobet-raport-i-monitorimit-te-punes-se-kuvendit-te-kosoves-per-vitin-2022/>), (Qasur për herë të fundit me 5 janar 2025).

[17] Po aty.

Në maj të vitit 2024, IKD, kishte analizuar këtë kod me ç'rast kishte gjetur se ai përmbante probleme të cilat minojnë efektivitetin dhe përafrimin e tij me Kushtetutën dhe standardet e parlamenteve demokratike. Drafti i propozuar nuk arrinte të vendoste vullnetin dhe veprimet politike për arritjen dhe ngritjen e standardeve etike por përqëndrohej në mënyrë ekskluzive tek rregullimi i sjelljes së deputetëve përmes sanksioneve përjashtuese dhe financiare të cilat përbëjnë dobësim të demokracisë përfaqësuese dhe se kufizimet që janë vendosur përmes këtij kodi reflektohen me cenim të përfaqësimit të qytetarëve përmes deputetëve që qytetarët kanë zgjedhur. Në anën tjetër, ky draft kod tejkalonte masat financiare në raport me Rregulloren e Kuvendit, nuk lejonte mjetin e ankesës në kundërshtim me Nenin 24 të Kushtetutës dhe cenonte përfaqësimin qytetar duke përjashtuar deputetët nga tre seanca në rast të ndonjë shkelje sipas këtij kodi.[18]

Rekomandim: Kuvendi i Kosovës të miratojë një Kod Sjelljeje më efektiv dhe pa të meta kushtetuese e ligjore dhe që rritë standardet etike pa cenuar përfaqësimin demokratik.

27. (Mos) Transparenca e Kuvendit

Kuvendi i Kosovës ende përballlet me mungesë transparence, veçanërisht në mos-publikimin e materialeve të plota lidhur me seancat parlamentare, përfshirë mocionet e grupeve parlamentare dhe rekomandimet e komisioneve. Ndërkohë që mbledhjet e komisioneve janë të hapura, ato nuk transmetohen drejtpërdrejt në faqen zyrtare ose përmes mediave publike, duke kufizuar qasjen e publikut.

Rekomandim: IKD rekomandon që Kuvendi të përmirësojë transparencën duke transmetuar këto mbledhje dhe të zbatojë në mënyrë efektive Planin e Veprimit për Kuvend të Hapur 2023-2026, që synon rritjen e qasjes, pjesëmarrjes dhe llogaridhënies.

28. Dështimi i Kuvendit për t'i publikuar materialet e komisioneve hetimore parlamentare

Komisionet hetimore parlamentare gjatë Legjislaturës VIII nuk respektuan parimet e transparencës duke mos transmetuar mbledhjet drejtpërdrejt dhe duke mos publikuar procesverbalet e mbledhjeve publike, ndonëse Ligji për Hetim Parlamentar nuk e ndalon një gjë të tillë, duke dëmtuar llogaridhënien dhe besimin publik.

Rekomandim: Kuvendi duhet të sigurojë transparencë të plotë të punës së komisioneve hetimore parlamentare përmes transmetimit publik të mbledhjeve dhe publikimit të dokumentacionit zyrtar.

29. Refuzimi i votimit të marrëveshjeve ndërkombëtare

Më shumë se një e treta e projektligjeve që janë proceduar për në Kuvendin e Kosovës, janë në formën e marrëveshjeve ndërkombëtare. Shumica parlamentare që udhëheq me Kuvendin dhe me Qeverinë nuk i ka votat e mjaftueshme për t'i kaluar,

[18] Naim Jakaj; Kodi i Sjelljes së Deputetëve; Kuvendi i Kosovës; (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2024/06/ALB-Kodi-i-Sjelljes-per-Deputetet-e-Kuvendit-te-Republikes-se-Kosoves-Analize-e-perputhshmerise-me-Parimet-Kushtetuese-Rregulloren-e-Kuvendit-dhe-me-standardet-e-parlamenteve-demokratike-1.pdf>), (Qasur për herë të fundit me 5 janar 2025).

për këtë arsye shumicës parlamentare i është dashur edhe mbështetja e opozitës parlamentare. Në këtë çështje, IKD ka gjetur se shumica parlamentare në asnjë rast nuk ka treguar proaktivitetin e saj që të konsultohet në mënyrë transparente me opozitën, për më shumë si Kryeministri, ministrat dhe deputetët kanë ofenduar në disa raste opozitën çka ka bërë që këta të fundit të pozicionohen në atë mënyrë që të mos votojnë marrëveshjet e proceduara.

IKD konsideron se edhe në rastet kur shumica parlamentare mund t'i ketë më shumë se 80 deputetë, ajo duhet t'i përfshijë deputetët e opozitës parlamentare në procesin e vendimmarrjes dhe në anën tjetër deputetët në parim nuk duhet të refuzojnë votimin e marrëveshjeve ndërkombëtare për arsye politike, përveç rasteve kur ato përmbajnë obligime financiare ose aspekte që bien ndesh me interesin publik.

Rekomandim: Kryeministri, ministrat dhe deputetët e shumicës parlamentare me rastin e procedimit të marrëveshjeve ndërkombëtare duhet të dialogojnë me opozitën dhe t'i shmangen motiveve politike në vendimmarrje në mënyrë që të sigurojnë miratimin e marrëveshjeve ndërkombëtare e të avancojnë interesin publik dhe përmirësojnë cilësinë e jetës së qytetarëve.

30. Refuzimi i pranimit të komenteve nga shoqëria civile

Kuvendi i Kosovës, në disa raste, refuzoi të marrë parasysh komentet dhe vërejtjet e shoqërisë civile gjatë procesit të hartimit dhe miratimit të projektligjeve.[19] Reforma në Drejtësi përmes procedimit të Ligjit për Këshillin Prokurorial, Ligjit për Byronë Shtetërore për Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme janë projektligje që Kuvendi nuk morri parasysh komentet e IKD-së. Të njejtat ligje më pas u vërtetuan në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës nga Gjykata Kushtetuese. Reforma zgjedhore në Kosovë shënoi përparim gjatë legjislaturës aktuale me miratimin e projektligjit për zgjedhjet e përgjithshme, megjithatë, Kuvendi nuk mori parasysh komentet dhe vërejtjet e shoqërisë civile dhe Avokatit të Popullit. Një rast tjetër, ku Kuvendi nuk morri parasysh komentet e shoqërisë civile është edhe me rastin e miratimit të Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave.

Rekomandim: Kuvendi t'i përfshijë dhe adresojë vërejtjet e shoqërisë civile, Avokatit të Popullit dhe Bashkësisë Ndërkombëtare gjatë hartimit të reformave të rëndësishme në mënyrë që të sigurohet përfaqësimi gjithëpërfshirës dhe respektim të standardeve kushtetuese.

Kryesia e Kuvendit duhet të propozojë për miratim në seancë plenare programin e sesionit të punës së Kuvendit, në përputhje me dispozitat e Rregullores, për të garantuar planifikim dhe efikasitet më të mirë.

31. Llogaridhënia e Qeverisë përballë Kuvendit

Njëri ndër funksionet kryesore të Kuvendit të Kosovës është edhe kontrolli parlamentar,

[19] Dërgimi i disa Ligjeve në Gjykatë, Miftaraj: Kjo legjislaturë ka probleme serioze për të siguruar që ato janë miratuar në pajtim me Kushtetutën; Zwri; 30 dhjetor 2024; (Shih linkun: <https://zeri.info/aktuale/519837/dergimi-i-disa-ligjeve-ne-gjykate-miftaraj-kjo-legjislature-ka-probleme-serioze-per-te-siguar-qe-ato-jane-miratuar-ne-pajtim-me-kushtetuten/>), (Qasur për herë të fundit me 5 janar 2025).

instrumentet e të cilit funksion, janë të parapara me Rregulloren e Kuvendit dhe me disa ligje të veçanta.

Gjatë legjislaturës së VIII-të, IKD ka identifikuar se Qeveria ka injoruar mekanizma e kontrollit parlamentar, si p.sh duke shmangur përgjigjet ndaj pyetjeve parlamentare të deputetëve, duke mos marrë pjesë në komisionet hetimore dhe duke mos marrur pjesë në seanca të jashtëzakonshme të thirrura nga opozita për çështje me interes publik.

Rekomandim: Qeveria e Kosovës të respektojë dhe t'i përgjigjet në mënyrë të plotë dhe transparente instrumenteve mbikëqyrëse të Kuvendit, përfshirë pyetjet parlamentare, komisionet hetimore dhe seancat e jashtëzakonshme, duke përmbushur detyrimet kushtetuese dhe ligjore për llogaridhënie.

32. Mungesa proaktive e Kryeminsitrit për të raportuar për zhvillimet në dialogun me Serbinë

Në raport me zhvillimet rreth dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, IKD ka gjetur se ka munguar qasja proaktive e Kryeministrit dhe e Zëvendëskryeministrit për të raportuar mbi zhvillimet në dialog. Mungesa e raportimit të një kryeministri para parlamentit për dialogun ndërmjet shtetit të tij dhe një shteti tjetër, paraqet mangësi të thellë të transparencës, llogaridhënies dhe kontrollit demokratik të institucioneve. Në situatën kur një kryeministër nuk i paraqet parlamentit detaje mbi negociatat, krijohet hendek në komunikimin dhe përgjegjshmërinë e qeverisë.

Rekomandim: Secili kryeministër dhe person përgjegjës apo përfaqësues i Republikës së Kosovës, në dialog me Serbinë apo ndonjë vend tjetër, duhet që t'i raportojnë dhe informojnë deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

33. Dështimi i Kuvendit për t'i zgjedhur organet kolegjiale dhe individuale

Njëri ndër rolet e rëndësishme të Kuvendit është roli zgjedhës i tij. Sipas këtij roli, në përputhje me kompetencat kushtetuese dhe ligjore, propozon dhe zgjedhë zyrtarë të ndryshëm në institucione të caktuara, funksionimi i të cilave varet pikërisht nga zgjedhja e këtyre zyrtarëve nga Kuvendi.

Përballë këtij roli, IKD gjenë se gjatë legjislaturës së VIII-të, me vonesa të theksuara Kuvendi nuk arriti që të zgjedhë një numër të konsiderueshëm të këtyre zyrtarëve. Kështu, në shumë raste, ka qenë pikërisht mosveprimi i Kuvendit arsyeja e mos funksionimit, të paktën funksionimit jo të plotë, të këtyre institucioneve.

Këto institucione përfshijnë përzgjedhjen e kandidatëve në Gjykatën Kushtetuese, anëtarët në Bordin e Komisionit të Pavarur të Mediave, Komisioni i Pavarur i Konkurrencës me 2 anëtar, Bordi i Ankesave i Mediave me një anëtar, Avokati i Popullit me një zëvendës Avokat të Popullit, Këshilli Gjyqësor i Kosovës me 2 anëtarë, Organin Shqyrtues i Prokurimit me një anëtar, Këshillit i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil me dy anëtarë nga komunitetet joshqiptare, Agjencia Kosovare e Pronës - Bordi Mbikëqyrës me

dy anëtarë, Agjencia Kosovare e Pronës - Komisioni për Kërkesa Pronësore, me një anëtar, Agjencia Kosovare e Pronës - Sekretariati Ekzekutiv, Drejtori dhe Zëvendësdrejtori, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale me një anëtar – Kryesues, Zyra e Rregullatorit për Energji me dy anëtarë, Agjencia Kosovare e Privatizimit me një anëtar- Kryesues, Bordi i Autoritetit Rregullativ i Hekurudhave me katër anëtarë, Bordi i Fondit të Kursimeve Pensionale, Guvernatori i BQK, Komisioni për Ndihmë Shtetërore në procedurë me katër anëtarë.

Legjislatura e VIII-të përfundoi duke mos marrë epilog final dy kandidatë për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese, dy anëtarë në Komisionin e Pavarur të Mediave dhe dy anëtarë të Bordit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës.

34. Abuzimi me të drejtën e shumicës në Komisionet Hetimore

Shumica parlamentare në Legjislaturën e VIII-të ka abuzuar me të drejtën e saj në dy aspekte, në njërin anë duke refuzuar themelimin e komisioneve hetimore për çështje të ndjeshme si kontratat njëburimore dhe në anën tjetër, edhe kur janë themeluar këto komisione, deputetët e shumicës parlamentare nuk kanë marrë pjesë në mbledhjet e komisioneve hetimore. Refuzimi i tillë tregon përpjekjen e shumicës për t'i shmangur debatet publike që mund të dëmtojnë reputacionin politik të qeverisë dhe partive në koalicion, duke cenuar kështu parimet e demokracisë parlamentare dhe përgjegjësinë ndaj qytetarëve.

Rekomandim: Kuvendi i Kosovës, të nisë ndryshimet e nevojshme në Ligjin për Hetim Parlamentar, sipas rekomandimeve të IKD-së ku të sigurohet përfaqësimi proporcional në komisionet hetimore, kryesimi të jetë nga radhët e inciuesit, vendosja e rregullave të qarta për pjesëmarrjen dhe kuorumin në mënyrë që të promovohet bashkëpunimi ndërmjet pozitës dhe opozitës.[20]

35. Refuzimi i shumicës parlamentare për t'i formuar Komisionet Hetimore

Në legjislaturën aktuale, Kuvendi i Kosovës ka dështuar të formojë disa komisione hetimore për çështje të rëndësishme publike, si hetimi i zjarreve në Institutin e Mjekësisë Ligjore dhe zhdukjes së mostrave në rastin Dehari, procedurat e prokurimeve të negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë, dhe përllogaritjen e borxheve të kompanive ambalazhuese të ujit. Këto dështime u shkaktuan kryesisht nga mungesa e kuoromit, respektivisht refuzimi i shumicës për të votuar, dhe kalimi i afateve ligjore për themelimin e komisioneve. Mospjesëmarrja e shumicës parlamentare dhe mungesa e konsensusit politik kanë penguar adresimin e këtyre çështjeve në nivel parlamentar. Për më tepër, mosrespektimi i afateve dhe rregullave të Ligjit për Hetim Parlamentar ka cenuar transparencën dhe përgjegjësinë e institucioneve shtetërore.

[20] Naim Jakaj; MOS EFIKASITETI I HETIMIT PARLAMENTAR – Mungesë e vullnetit dhe problemet ligjore; Kuvendi i Kosovës; (Shih linkun: <https://klicks.org/mos-efikasiteti-i-hetimit-parlamentar-mungese-e-vullnetit-dhe-problemet-ligjore/>), (Qasur për herë të fundit me 5 janar 2025).

Rekomandim: Shumica parlamentare duhet t'i mirëpresë iniciativat e opozitës parlamentare kur ato kanë për qëllim hetimin e çështjeve që bien në fushëveprim të Ligjit për Hetim Parlamentar. Shumica parlamentare, duhet të respektojë të drejtën e të gjithë deputetëve, duke mos refuzuar formimin e komisioneve hetimore për çështjet problematike të ngritura nga opozita, në mënyrë që të sigurohet transparenca, llogaridhënia dhe trajtimi i interesit publik.

36. Refuzimi për t'i hetuar çështjet e propozuara

Neni 4, paragrafi 3 i Ligjit për Hetim Parlamentar, detyron Kuvendin të themelojë komision hetimor kur kërkohet nga një e treta e deputetëve, duke siguruar mbikëqyrje efektive të ekzekutivit dhe balancimin e pushteteve. Megjithatë, zvarritjet nga shumica parlamentare, si në rastin e hetimit për menaxhimin e krizës energjetike, kanë shkelur këtë ligj dhe dobësuar mbikëqyrjen parlamentare, duke rrezikuar transparencën dhe llogaridhënien. Neni 4 i LHP-së, garanton që pakica parlamentare t'i adresojë çështje kritike përmes mundësisë që një bashkësi numrash prej më së pakuy 1/3 e deputetëve të ngritin çështje e në këtë mënyrë kontributi i tyre të jetë në forcim të llogaridhënies, të demokracisë dhe qeverisjes së përgjegjshme.

Rekomandim: Kuvendi duhet të zbatojë në mënyrë të saktë dhe të qartë dispozitat ligjore për themelimin e komisioneve hetimore sipas kërkesës së një të tretës së deputetëve, duke shmangur çdo vonesë apo zvarritje. Kjo përgjegjësi bie ekskluzivisht mbi Kryetarin e Kuvendit, që ai një interpretim të tillë ta vendosë në skenar të tij kur ka këso raste të themelimit të komisioneve hetimore.

37. Kundërligjshmëria me rastin e procedimit të Raportit të Komisionit Hetimor

Sa i përket kundërligjshmërisë, Kuvendi vendosi në rend të ditës miratimin e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për masat emergjente me furnizimin e energjisë. Edhe pse një vendim i tillë ishte proceduar brenda afateve të parapara me Ligjin për Energjinë, ky vendim tejkalonte periudhën maksimale prej 180 ditëve që Kuvendi mund t'i jepte autorizime Qeverisë. Rasti i dytë që lidhet me kundërligjshmërinë është ai me rastin e miratimit të Raportit të Komisionit Hetimor Parlamentar për menaxhimin e krizës energjetike nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ku Kryesia e Kuvendit procedoi kundërligjshëm miratimin e këtij raporti, në anën tjetër edhe Kuvendi miratoi këtë raport duke qenë në dijeni për kundërligjshmërinë e këtij raporti.

Rekomandim: Kuvendi duhet të sigurohet që çdo raport ose dokument i proceduar nga Komisionet Hetimore të jetë në pajtim me procedurat ligjore dhe kushtet që përcaktohen nga Ligji për Hetim Parlamentar dhe Rregullorja e Kuvendit të Kosovës. Miratimi i raportit të Komisionit Hetimor për menaxhimin e krizës energjetike, përkundër kundërligjshmërisë së evidentuar, tregon mangësi në vlerësimin e ligjshmërisë para miratimit.

38. Kundërkushtetutshmëri me rastin e ngritjes së komisionit hetimor

Në një rast, IKD, gjen se kuvendi themeloi në kundërshtim me kushtetutën komisionin hetimor parlamentar në lidhje me rastet e dhunës seksuale dhe dhunës në familje ngase ai shkel parimet e ndarjes së pushteteve të përcaktuara me Kushtetutë dhe me standarde ndërkombëtare.[21] Sistemi i drejtësisë nuk mund t'i raportojë në asnjë rrethanë pushtetit legjislativ, qoftë edhe përmes një komisioni hetimor.

Rekomandim: Kryetari i Kuvendit të sigurohet se ka bazë të mjaftueshme kushtetuese dhe ligjore që propozime të tilla të mos procedohen për në seancë plenare. Diskutimi të ndodhë në kryesi dhe aty vendimmarrja të jetë objektive dhe në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin për Hetim Parlamentar dhe në rast se propozuesi nuk pajtohet me vendimin e Kryesisë, ai mund ta atakojë pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë për konflikt administrativ – por, jo të shkojë në seancë një përfundim jokushtetues.

39. Mos serioziteti i deputetëve

Në disa raste, IKD ka evidentuar mos seriozitet të deputetëve gjatë seancave parlamentare, një fenomen i tillë që shpesh herë e ka përcjellur Kuvendin gjatë kësaj legjislature e që reflekton mungesë të përkushtimit ndaj detyrës së tyre si përfaqësues të qytetarevë. Në seancën e 30 tetorit, por edhe në dhjetëra seanca të tjera, shumica e projektligjeve u votuan vetëm pas përsëritjes së votimeve 2-3 herë, për shkak të mungesës së seriozitetit nga deputetët të shumicës parlamentare, të cilët, megjithëse kishin 61 vota, shpesh nuk votonin.

Rekomandim: Deputetët duhet të jenë të angazhuar për të mirën publike dhe punën në Kuvend ta marrin me shumë seriozitet dhe prioritet dhe jo për të krijuar situata të papranueshme në Kuvend, sikurse me këtë seancë.

40. Dështimi në përmbushjen e agjendës legjislative

Legjislatura e VIII-të, edhe pse zhvilloi punë pa planifikim, ajo përmbante agjendë legjislative ambicioze për t'u përmbushur, e për më tepër kjo agjendë ishte e diktuar nga propozimet e Qeverisë. Të dhënat tregojnë se viti 2022 përfundoi duke mos u shqyrtuar në parim nëntë projektligje dhe në lexim të dytë dy projektligje[22], ndërsa në vitin 2023 përkundër që i shqyrtoi, Kuvendi nuk arriti t'i miratojë gjashtë marrëveshje ndërkombëtare, tri projektligje në lexim të dytë dhe shtatë projektligje në lexim të parë.[23] Ndërsa, legjislatura e VIII-të përfundoi duke mos marrë epilog 43 projektligje.[24]

[21] IKD: Kuvendi miratoi Komision Hetimor në kundërshtim me Kushtetutën; Betimi për Drejtësi; (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ikd-kuvendi-miratoi-komision-hetimor-ne-kundershtim-me-kushtetuten/>), (Qasur për herë të fundit me 5 janar 2025).

[22] Naim Jakaj; DOBET – Raport i monitorimit të punës së Kuvendit të Kosovës për vitin 2022; 2023; (Shih linkun: <https://kli-ks.org/dobet-raport-i-monitorimit-te-punes-se-kuvendit-te-kosoves-per-vitin-2022/>), (Qasur për herë të fundit me 5 janar 2025).

[23] Naim Jakaj; Kuvendi i dështimeve; Instituti i Kosovës për Drejtësi; (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2024/04/ËEB-Kuvendi-i-deshitimeve-Raport-i-monitorimit-te-punes-se-Kuvendit-te-Kosoves-per-vitin-2023-.pdf>), (Qasur për herë të fundit me 5 janar 2025).

[24] Lista e projektligjeve dhe ligjeve të miratuara; Kuvendi i Kosovës; (Shih linkun:

https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/Evidencaellegjeve_Dd4GK3uFfn.pdf), (Qasur për herë të fundit me 5 janar 2025).

Rekomandim: Kuvendi i Kosovës, të miratojë Programin e Punës në mënyrë që të planifikojë në mënyrë adekuate edhe procedimin e këtyre projektligjeve në seancë plenare. Planifikimi legjislativ duhet të shoqërohet me angazhim konkret dhe afate të realizueshme, duke garantuar përmbushjen e plotë të agjendës së miratuar, si një reflektim i përgjegjshmërisë dhe efektivitetit në shërbim të interesit shtetëror dhe qytetar.

Annex 1: Aktiviteti total i deputetëve

Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë detyrimin kushtetues dhe moral të jenë aktiv në përmbushjen e përgjegjësi të tyre legjislative dhe përfaqësuese. Pjesëmarrja e rregullt në seanca plenare, komisione dhe aktivitete të tjera parlamentare është thelbësore për të garantuar funksionimin efektiv të institucionit dhe për të adresuar nevojat dhe interesat e qytetarëve që ata përfaqësojnë. Mungesat e vazhdueshme apo pasiviteti dëmtojnë procesin demokratik dhe reduktojnë efikasitetin e Kuvendit.


Rekomandim: Deputetët duhet të angazhohen aktivisht në punimet e Kuvendit, duke marrë pjesë në të gjitha seancat dhe komisionet parlamentare dhe duke kontribuar me fjalime për çështjet e parashtruara.

Nga monitorimi i të gjitha fjalimeve të deputetëve të Kuvendit, rezulton se gjatë legjislaturës së VIII-të, deputetët e Kuvendit kanë mbajtur gjithsej 6782 fjalime. Në vijim janë paraqitur çështjet të cilat kanë qenë objekt i trajtimit nga deputetët:

Tema/Çështja	Numri i deklaratave	%	Tema/Çështja	Numri i deklaratave	%
Ekonomi dhe Financa	1383	20.39%	Infrastrukturë	203	2.99%
Drejtësi	844	12.44%	Kulturë dhe Sport	111	1.63%
Mirëqenie Sociale	546	8.05%	Mjedis	100	1.47%
Shëndetësi	472	6.95%	Zgjedhja e organeve kolegjiale	74	1.09%
Energji	459	6.76%	Çështje dhe qeverisje komunale	67	1%
Dialogu Kosovë-Serbi	406	5.98%	Bujqësi	67	1%
Siguri	401	5.91%	Histori	58	0.9%
Arsim	317	4.67%	Çështje gjinore	43	0.6%
Punë të Jashtme dhe Integritet Evropian	305	4.49%	Të drejtat e komuniteteve	32	0.5%
Për procedurë	303	4.46%	Liria e medias	24	0.4%
Administratë publike	298	4.39%	Diasporë	9	0.1%
Efikasitet në qeverisje	260	3.83%			

Tabela nr. 1 - Numri i deklaratave të deputetëve në bazë të 23 temave të ngritura gjatë aktivitetit në seancat plenare të Kuvendit

Grupi me më së shumti deklarata në të gjithë aktivitetin parlamentar është ai i Lëvizjes VETËVENDOSJE!, i pasuar nga ai i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), më tutje nga ai i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Grupit Parlamentar MULTIETNIK, deputetët pa grup parlamentar dhe në fund Lista Serbe.



Treguesi nr. 2 - Numri total i deklaratave në bazë të grupeve parlamentare

Në bazë të të dhënave rezultojnë se 20 deputetë të Kuvendit nuk kanë ngritur asnjë çështje në seancë planore nga totali i 6782 deklaratave në këtë legjislaturë. Këta deputetë janë të GP të Listës serbe dhe një deputet pa grup parlamentar.

Në lidhje me numrin e vogël të disa deklaratave të deputetëve, duhet shtuar faktin se disa prej tyre nuk e kanë përfunduar mandatin e plotë. Në këtë listë të deputetëve hyjnë, deputetja Vassije Blar, deputetët që kandiduan dhe që u zgjodhën kryetarë të komunave: Bedri Hamza, Alban Hyseni, Fadil Nura dhe Uran Ismaili.

Nr.	Emri dhe Mbiemri i Deputetit/es	Grupi Parlamentar	Numri i Deklaratave	Nr.	Emri dhe Mbiemri i Deputetit/es	Grupi Parlamentar	Numri i Deklaratave
1	Besnik Tahiri	AAK	369	16	Hajdar Beqa	PDK	133
2	Abelard Tahiri	PDK	278	17	Eliza Hoxha	PDK	128
3	Bekim Haxhiu	PDK	220	18	Pal Lekaj	AAK	113
4	Armend Muja	LV	211	19	Avdullah Hoti	LDK	111
5	Mimoza Kusari Lila	LV	210	20	Hisen Berisha	PDK	107
6	Arben Gashi	LDK	199	21	Mërgim Lushtaku	PDK	102
7	Hykmete Bajrami	LDK	187	22	Haki Abazi	PG	93
8	Armend Zemaj	LDK	185	23	Ardian Gola	LV	90
9	Adnan Rrustemi	LV	176	24	Mirlinda Tishukaj Sadiku	LV	90
10	Ferat Shala	PDK	167	25	Jeta Statovci	LV	89
11	Time Kadrijaj	AAK	162	26	Rashit Qalaj	PDK	89
12	Driton Selmanaj	LDK	161	27	Besian Mustafa	LDK	81
13	Ganimete Musliu	PDK	148	28	Elmi Reçica	PDK	81
14	Ariana Musliu Shoshi	PDK	147	29	Jahja Kokaj	LV	80
15	Blerta Deliu Kodra	PDK	138	30	Valentina Bunaku Rexhepi	LDK	78

Tabelat 3-4 - Numri i deklaratave të deputetëve në të gjithë aktivitetin e Kuvendit për legjislaturën e VIII-të

Nr.	Emri dhe Mbiemri i Deputetit/es	Grupi Parlamentar	Numri i Deklaratave	Nr.	Emri dhe Mbiemri i Deputetit/es	Grupi Parlamentar	Numri i Deklaratave
31	Shemsedin Dreshaj	AAK	74	46	Albena Reshitaj	AAK	52
32	Doarsa Kica Xhelili	LDK	72	47	Floretë Zejnullahu	PDK	50
33	Ramush Haradinaj	AAK	71	48	Arjeta Fejza	LV	46
34	Albana Bytyqi	AAK	67	49	Eman Rrahmani	LV	43
35	Bekë Berisha	AAK	64	50	Valon Ramadani	LV	42
36	Fitore Pacolli Dalipi	LV	63	51	Arijeta Rexhepi	LV	35
37	Enver Dugolli	LV	61	52	Nijazi Isaku	LV	35
38	Memli Krasniqi	PDK	61	53	Anton Quni	LDK	34
39	Isak Shabani	PDK	59	54	Artan Abrashi	LV	34
40	Fatmire Kollçaku Mulhaxha	LV	58	55	Enver Hoxhaj	PDK	34
41	Dimal Basha	LV	57	56	Visar Korenica	LV	34
42	Enis Kërvan	MULTIETNIQ	57	57	Arbëreshë Kryeziu Hyseni	LV	33
43	Driton Hyseni	LV	54	58	Ardian Kastrati	PDK	32
44	Lumir Abdixhiku	LDK	54	59	Milazim Salijaj	LV	32
45	Rrezarta Krasniqi	LDK	53	60	Enver Haliti	LV	30

Nr.	Emri dhe Mbiemri i Deputetit/es	Grupi Parlamentar	Numri i Deklaratave	Nr.	Emri dhe Mbiemri i Deputetit/es	Grupi Parlamentar	Numri i Deklaratave
61	Haxhi Avdyli	LV	30	76	Mirsad Shkreta	LV	22
62	Xhavit Haliti	PDK	30	77	Arbër Rexhaj	LV	21
63	Agon Batusha	LV	29	78	Jetmire Vrenezi	LV	21
64	Besim Muzaqi	LV	29	79	Agim Veliu	LDK	20
65	Tinka Kurti	LV	29	80	Fridon Lala	MULTIETNIQ	20
66	Vlora Dumoshi	LDK	28	81	Shqipe Mehmeti Selimi	LV	20
67	Arta Bajralia	LV	27	82	Fidan Jilta	MULTIETNIQ	19
68	Duda Balje	MULTIETNIQ	27	83	Luan Aliu	LV	18
69	Marigona Geci	LDK	27	84	Shqipe Isufi	LV	18
70	Fadil Nura	PDK	26	85	Glauk Konjufca	LV	17
71	Kujtim Shala	LDK	26	86	Vendenis Lahu	LV	17
72	Burim Meta	LV	25	87	Alban Bajrami	LV	16
73	Fjolla Ujkani	LV	25	88	Ylleza Hoti	LV	15
74	Halil Thaçi	LV	24	89	Avni Dehari	LV	14
75	Bedri Hamza	PDK	22	90	Fatmir Humolli	PG	14

Nr.	Emri dhe Mbiemri i Deputetit/es	Grupi Parlamentar	Numri i Deklaratave	Nr.	Emri dhe Mbiemri i Deputetit/es	Grupi Parlamentar	Numri i Deklaratave
91	Gani Krasniqi	LV	13	106	Salih Zyba	LV	7
92	Labinotë Demi Murtezi	LV	13	107	Nasuf Bejta	LV	6
93	Saranda Bogujevci	LV	13	108	Alban Hyseni	LV	4
94	Erxhan Galushi	MULTIETNIQ	12	109	Ekrem Mustafa	LV	3
95	Hydajet Hyseni - Kaloshi	LV	12	110	Adem Hodza	LS	2
96	Mefal Bajqinovci	LV	12	111	Behgjet Pacolli	LDK	2
97	Adriana Matoshi	LV	11	112	Samra Iljaz	MULTIETNIQ	2
98	Fitim Uka	LV	11	113	Slavko Simic	LS	2
99	Gazmend Gjyshinca	LV	11	114	Bekim Arifi	MULTIETNIQ	1
100	Gramoz Agusholli	LV	11	115	Drita Millaku	LV	1
101	Uran Ismaili	PDK	11	116	Vasfije Bler	LV	1
102	Adelina Grainca	LV	9	117	Biljana Maksic	LS	0
103	Fitim Haziri	LV	8	118	Branislac Nikolic	LS	0
104	Bahrim Sabani	MULTIETNIQ	7	119	Cvetko Veljkovic	LS	0
105	Igor Simic	LS	7	120	Dragana Antonijevic	LS	0

Tabelat 5-10 - Numri i deklarave të deputetëve në të gjithë aktivitetin e Kuvendit për legjislaturën e VIII-të

Nr.	Emri dhe Mbiemri i Deputetit/es	Grupi Parlamentar	Numri i Deklaratave
121	Fadil Gashi	PG	0
122	Jasmina Dedic	LS	0
123	Ksenija Bozovic	LS	0
124	Ljubinko Karadzic	LS	0
125	Milan Joksimovic	LS	0
126	Milan Kostic	LS	0
127	Miljana Nikolic	LS	0
128	Milos Perovic	LS	0
129	Nenad Radenkovic	LS	0
130	Olivera Zdravkovic	LS	0
131	Rados Mihajlovic	LS	0
132	Svetislav Jokic	LS	0
133	Verica Ceranic	LS	0
134	Zoran Maksimovic	LS	0
135	Zoran Mojsolovic	LS	0
136	Ivan Todosijevic	LS	0

Tabela 11 - Numri i deklaratave të deputetëve në të gjithë aktivitetin e Kuvendit për legjislaturën e VIII-të

Annex 2: Kuvendi në numra

Më 22 mars 2021, u konstitua Kuvendi i Kosovës pas zgjedhjeve parlamentare të mbajtura në shkurt të po këtij viti. Në po të njëjtën seancë, Kuvendi zgjodhi për Kryetar të Kuvendit, Glauk Konjufcën, nga partia më e madhe parlamentare si dhe u zgjodh Qeveria e Kosovës, në krye të së cilës ishte votuar Kryeministri Albin Kurti.

Gjatë kësaj legjislature, ishte një deputete nga ana e GP të PDK-së, Adelina Grainca e cila kaloi në GP të LVV-së, dhe një deputete nga LVV, Doarsa Kica Xhelili, që kaloi në GP të LDK-së.

Dy deputetë të GP të LVV-së, Fatmir Humolli dhe Haki Abazi, dhanë dorëheqje nga ky grup por duke qëndruar në kuvend si deputetë të pavarur. Bazuar në rezultatin dhe zgjedhor dhe ndryshimet e bëra, në fund të Legjislaturës së VIII-të, përbërja e grupeve parlamentare të konfirmuara ishte si në vijim:

Nr.	Grupi parlamentar	Numri i deputetëve më 22 mars 2021	Numri i deputetëve më 31 dhjetor 2023
1	Lëvizja VETËVENDOSJE!	58	56
2	Partia Demokratike e Kosovës	19	18
3	Lidhja Demokratike e Kosovës	15	16
3	Lista Serbe	10	9
4	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës	8	8
5	Multietnik	8	8
6	Pa grup parlamentar	2	5

Tabela nr. 15 - Përbërja e grupeve parlamentare të konfirmuara deri në fund të vitit 2024

Struktura e deputetëve në bazë të gjinisë: 40 gra - 80 burra.

Udhëheqja e komisioneve parlamentare, në bazë të grupeve parlamentare

7

Lëvizja VETËVENDOSJE!

2

Partia Demokratike e Kosovës

2

Lidhja Demokratike e Kosovës

1

**Aleanca për
Ardhmërinë e Kosovës**

0

Lista Serbe

1

GP Multietnik

Puna e IKD-së në Programin Qeverisja e Mirë

Në vitin 2021, IKD themeloi Programin “Qeverisja e mirë”, ku si rezultat i këtij programi, dhe me mbështetjen e donatorëve (Rockefeller Brothers Fund, National Endowment for Democracy, Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan, IKD arriti të kryejë aktivitete të cilat përfshinin pjesëmarrjen në grupet punuese në Kuvendin e Kosovës për shqyrtimin dhe hartimin e projektligjeve të ndryshme, analizimin dhe publikimin e dokumenteve të politikave, publikimin e raporteve monitoruese, mbajtjen e tryezave të ndryshme dhe reagimeve përmes medieve për tema që lidhen me programin.

📖 Rregullorja e re e Punës së Kuvendit: mes nevojës për efikasitet dhe respektim të Kushtetutës

📅 Publikuar: Mars 2022

Skano për të lexuar analizën e plotë



🌐 Ose kliko këtu: <https://kli-ks.org/rregullorja-e-re-e-punes-se-kuvendit-mes-nevojes-per-efikasitet-dhe-respektim-te-kushtetutes/>

📖 Qeveria: mes planifikimit dhe zbatimit

📅 Publikuar: 2022

Skano për të lexuar analizën e plotë



🌐 Ose kliko këtu: <https://kli-ks.org/qeveria-mes-planifikimit-dhe-zbatimit/>

⚠️ Politizimi kundërkushtetues i Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas

📅 Publikuar: 2022

Skano për të lexuar analizën e plotë



🌐 Ose kliko këtu: <https://kli-ks.org/politizimi-kunder-kushtetues-i-anj/>

📖 Tendencat për politizim të Këshillit të Pavarur Mbrojtës të Shërbimit Civil të Kosovës

📅 Publikuar: 2022

Skano për të lexuar analizën e plotë



🌐 Ose kliko këtu: <https://kli-ks.org/tendencat-per-politizim-te-kpmshck/>

📖 Masat represive për mbrojtjen e grave

📅 Publikuar: 2022

Skano për të lexuar analizën e plotë



🌐 Ose kliko këtu: <https://kli-ks.org/masat-represive-per-mbrojtjen-e-grave/>

🔒 (MOS) Transparenca në qeverisje

📅 Publikuar: 2022

Skano për të lexuar analizën e plotë



🌐 Ose kliko këtu: <https://kli-ks.org/mos-transparenca-ne-qeverisje/>

🔒 (MOS) Transparenca e ndërmarrjeve publike

📅 Publikuar: 2022

Skano për të lexuar analizën e plotë



🌐 Ose kliko këtu: <https://kli-ks.org/mos-transparenca-e-ndermarrjeve-publike/>

📖 Qeverisja me duar të pastërta

📅 Publikuar: 2022

Skano për të lexuar analizën e plotë



🌐 Ose kliko këtu: <https://kli-ks.org/qeverisja-me-duar-te-pasterta/>

Projektligji për Pagat në Sektorin Publik

Publikuar: 2022

Skano për të lexuar analizën e plotë



Ose kliko këtu: [\(MOS\) Transparenca e ndërmarrjeve publike](#)

DOBËT – Raport i monitorimit të punës së Kuvendit të Kosovës për vitin 2022

Publikuar: 2023

Skano për të lexuar analizën e plotë



Ose kliko këtu: [DOBËT – Raport i monitorimit të punës së Kuvendit të Kosovës për vitin 2022](#)

Kushtetutshmëria në qeverisje

Publikuar: 2023

Skano për të lexuar analizën e plotë



Ose kliko këtu: [Kushtetutshmëria në qeverisje](#)

Ndërmarrjet publike larg syve të publikut

Publikuar: 2023

Skano për të lexuar analizën e plotë



Ose kliko këtu: [Ndërmarrjet publike larg syve të publikut](#)

Kuvendi i dështimeve

Publikuar: 2024

Skano për të lexuar analizën e plotë



Ose kliko këtu: [Kuvendi i dështimeve](#)

Kodi i sjelljes së deputetëve

Publikuar: 2024

Skano për të lexuar analizën e plotë



Ose kliko këtu: [Kodi i sjelljes së deputetëve](#)

Planifikimi jo adekuat i Qeverisë

Publikuar: 2023

Skano për të lexuar analizën e plotë



Ose kliko këtu: [Planifikimi \(Jo\) adekuat i Qeverisë](#)

Doracak – Nismat legislative për qytetarë

Publikuar: 2023

Skano për të lexuar analizën e plotë



Ose kliko këtu: [Doracak – Nismat legislative për qytetarë](#)

Ndërhyrjet në sistemin e drejtësisë përmes deklaratave publike

Publikuar: 2023

Skano për të lexuar analizën e plotë



Ose kliko këtu: [Ndërhyrjet në sistemin e drejtësisë përmes deklaratave publike](#)

PRIORITETET – që vazhdojnë të mos arrihen

Publikuar: 2024

Skano për të lexuar analizën e plotë



Ose kliko këtu: [PRIORITETET – që vazhdojnë të mos arrihen](#)

Doracaku për shpalljen e grevës së ligjshme

Publikuar: 2024

Skano për të lexuar analizën e plotë



Ose kliko këtu: [Doracaku për shpalljen e grevës së ligjshme](#)

Gjykimi brenda afatit të arsyeshëm

Publikuar: 2024

Skano për të lexuar analizën e plotë



Ose kliko këtu: [Gjykimi brenda afatit të arsyeshëm](#)

Problemet e reformës në drejtësi

 Publikuar: 2024

Skano për të lexuar analizën e plotë



 Ose kliko këtu: [Problemet e reformës në drejtësi](#)

Llogaridhënia

 Publikuar: 2024

Skano për të lexuar analizën e plotë



Ose kliko këtu: [Llogaridhënia](#)

Shteti neglizhon harmonizimin e pensioneve me koston e jetesës

 Publikuar: 2024

Skano për të lexuar analizën e plotë



 Ose kliko këtu: [Shteti neglizhon harmonizimin e pensioneve me koston e jetesës](#)

MUNGESA E KONTRATAVE KOLEKTIVE – Dështimi për të siguruar dialog social dhe mbrojtje kolektive të punëtorëve

 Publikuar: 2024

Skano për të lexuar analizën e plotë



Ose kliko këtu: [MUNGESA E KONTRATAVE KOLEKTIVE – Dështimi për të siguruar dialog social dhe mbrojtje kolektive të punëtorëve](#)

MOS EFIKASITETI I HETIMIT PARLAMENTAR – Mungesë e vullnetit dhe problemet ligjore

 Publikuar: 2024

Skano për të lexuar analizën e plotë



 Ose kliko këtu: [MOS EFIKASITETI I HETIMIT PARLAMENTAR – Mungesë e vullnetit dhe problemet ligjore](#)

Qeverisja me duar të pastra dhe hetimi i korrupsionit qeveritar

 Publikuar: 2024

Skano për të lexuar analizën e plotë



Ose kliko këtu: [Qeverisja me duar të pastra dhe hetimi i korrupsionit qeveritar](#)

Mosveprimi i kuvendit shkel të drejtat e 90,696 zyrtarëve publik dhe rrezikon buxhetin shtetëror

 Publikuar: 2024

Skano për të lexuar analizën e plotë



 Ose kliko këtu: [Mosveprimi i kuvendit shkel të drejtat e 90,696 zyrtarëve publik dhe rrezikon buxhetin shtetëror](#)

Raporti **"Monitoruesi i Legjislaturës së VIII-të"** është realizuar nga Instituti i Kosovës për Drejtësi me mbështetjen e Rockefeller Brothers Fund.

